

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

A.M.E 2020

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K83725201G

NUIS/NIPT

Ura e Gjoles, Nr.Pasurie 421/6, Zone Kadastrale 1299

Adresa

Durrës

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0675004441

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

akajmaku@yahoo.com

E-mail

ADMINISTRATOR Fluked Tërpo

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2024/03/07

Data (viti/muaji/dita)

0675004441

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-96978-02-29-2024

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Bashkia Durres

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

16138970

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Gjeberim ne qytet

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/03/18

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2024/03/18

Numri i njoftimit

CN/41701/02292024

Kodi CPV

03452000-3 - Pemë,

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 Per prokurimin publik; VKM 285, date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar; Praktika e ndjekur nga KPP per çështje te ngjashme.

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Ne datën 01.03.2024 autoriteti kontraktor Bashkia Durrës ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt “Gjelberimi ne Qytet”, REF-96978-02-29-2024, e llojit Procedurë e Hapur, Mall, me Fondi limit: 16’138’970 (Gjashtembedhjetë milion e njëqind e tridhjetë e tete mije e nentëqind e shtatedhjetë) lekë pa Tvsh. Parashikuar per tu zhvilluar me date 18.03.2024 ora 10.00.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Shoqeria jone pasi eshte njohur me procedurën e publikuar dhe dokumentat e tenderit, kemi interesin e ligjshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Pasi kemi vlerësuar dhe shqyrtuar dokumentat e tenderit dhe kriteret e kualifikimit, kemi vërejtur disa parregullsi ose pasaktësi në hartimin e kriterëve të kualifikimit në DT.

Se pari, kriteri i vendosur nga AK, pika 2.3.b e kriterëve të veçanta ku përcaktohet se “Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

? N.P-12 B (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.”

Ky kriter është i ekzagjuar dhe jo proporcional, duke rënë në kundërshtim me LPP dhe VKM nr 285/2021, e ndryshuar, me VKM nr. 42, datë 16.1.2008, VKM nr.943 datë 28.12.2016, pasi, Licenca N.P. – 12, kategoria B është kategori e ekzagjuar dhe është për realizim punimesh në vlera nga 21 – 50 milion lek të reja, ndërkohë fondi limit që prokurohet është: 16’138’970 (Gjashtembedhjetë milion e njëqind e tridhjetë e tete mije e nentëqind e shtatedhjetë) lekë pa Tvsh.

Ky kriter duhet të ishte N.P – 12 A, për vlera punimesh deri në 20 milion lek, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës që leshon këto licenca.

Kategoria e kërkuar N.P-12 B, e tejkalon vlerën e punimeve sipas kategorisë përkatesë dhe gjithashtu tejkalon edhe vlerën e kontratës që prokurohet.

AK duhet të modifikojë këto kriter, pasi nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Se dyti, kriteri i vendosur nga AK, pika 2.3.d e kriterëve të veçanta ku përcaktohet se “Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën gjashtë muajt e fundit të cilat i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës:

? 1 (një) Agronom të shoqëruar me diplomë, cv, kontrate pune, dhe të jete i pajisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit.

? 1 (një) inxhinier Pyjesh i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune.

? 1 (një) inxhinier Mjedisit i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune dhe të jete i pajisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit.

? 1 (një) Automaknist, i shoqëruar me kontrate pune, dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartele personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT .

? 1 (një) Eskavatorist i shoqëruar kontrate pune, dëshminë e aftësisë profesionale ose leje

manovrimi te vlefshme te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT.

? 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”punime në sipërfaqe gjelbërta” që vërtetohen me certifikata profesionale, leshuar nga institucionet e autorizuara me ligj, te shoqëruar me kontrate pune.

? 10 (dhjetë) punëtorë të thjeshtë, te shoqëruar me kontrate pune.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Ky kriter eshte i ekzagjeruar dhe jo proporcional, duke qene ne kundërshtim me LPP dhe VKM nr 285/2021, të ndryshuar. AK nuk duhet te kerkoje disponimin e stafit për periudhën gjashtë muajt e fundit.

Kriteret teknike kualifikuese duhet të kenë lidhje dhe të jenë në proporcion me objektin e kontratës.

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe Rekomandimeve te here pas hershme të APP ”Për hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”, AK, nuk mund të kërkojë staf teknik të punësuar për periudhën gjashtë muajt e fundit të cilat i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës

Minimumi që AK, duhet të kërkojë në kriteret teknike, pika 2.3, germa b) duhet të jetë staf teknik të punësuar për periudhën e muajit të fundit të cilat i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës.

Se treti, AK duhet te modifikojë kërkesën ku kerkohet 1 (një) Agronom te shoqëruar me diplomë, cv, kontrate pune, dhe te jete i pajisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit.

AK, është e paqartë në formulimin e kriterit të lartpërmendur, sepse nuk ka përcaktuar se çfarë lloj Certifikate te leshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të jetë i paisur Agronomi??

Me çfarë kualifikimi/certifikimi e kërkon agronomin nga Ministria e Mjedisit??

Referuar ëbbsite-it te Ministrise se Mjedisit nuk rezulton ndonjë lloj certifikimi nga kjo Ministri per Agronomet. Po ashtu dhe nga lista e shërbimeve ne e-albania, nuk ekziston asnjë lloj shërbim certifikimi te Agronomeve

Ky kriter eshte i paqartë dhe sjell konfuzion tek Operatorët Ekonomikë të interesuar për procedurën e prokurimit me objektin e sipërcituar.

Kriteret teknike, duhet të kenë lidhje dhe të jenë në proporcion me objektin e kontratës

Se katërti, AK duhet te modifikojë kërkesën ku kerkohet 1 (një) inxhinier Mjedisi i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune dhe te jete i pajisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit, pasi nuk ka përcaktuar llojin e Certifikates te leshuar nga Ministria e Mjedisit

AK, është e paqartë në formulimin e kriterit të lartpërmendur, sepse nuk ka përcaktuar se çfarë lloj Certifikate te leshuar nga Ministria e Mjedisit duhet të jetë i paisur Inxhinieri i Mjedisit??

Me çfarë kualifikimi/certifikimi e kërkon inxhinierin e mjedisit nga Ministria e Mjedisit ??

Ky kriter eshte i paqartë dhe sjell konfuzion tek Operatorët Ekonomikë të interesuar për procedurën e prokurimit me objektin e sipërcituar.

Kriteret duhet të kenë lidhje dhe të jenë në proporcion me objektin e kontratës

Se pesti, kriteri i vendosur nga AK, pika 2.3.f e kriterëve te veçanta ku përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat :

Operatori ekonomik duhet paraqese Certifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të matrialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative).

ose

Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe leshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjine të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative). Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë furnizimi nga subjekti importues, ku të jetë pajisur me këto dokumenta:

- ? Certifikatë Origjine nga shteti importues.
- ? Certifikate Fitosanitare nga shteti importues.
- ? Varietetet të jenë të regjistruara në katalogun kombëtar shqiptar.””

Ky kriter është diskriminues, jo proporcional dhe në shkelje të hapur të legjislacionit të prokurimit në fuqi, pasi, referuar Dokumentave të Tenderit dhe Preventivit konstatohet se 2 nga zërat e varieteteve të fidanëve, konkretisht:

- Kumbull e kuqe - Prunus Caracifera;
- Stipa - Stipa tenuissima,

që autoriteti kontraktor po prokuron nuk janë të regjistruara në Katalogun Kombëtar Shqiptar të Varieteteve.

Si mund të prokurojë Autoriteti Kontraktor një mall të përgjithshëm në Katalogun Kombëtar dhe akoma më tej, të jetë kriter skualifikues në qoftë se ky varietet nuk do të jete i Regjistruar në Katalogun Kombëtar????!!

Kerkojme nga AK modifikimin e këtij kriteri, pasi është diskriminues dhe në shkelje të legjislacionit në fuqi për prokurimin.

Kerkojme që AK të mos e prokurojë këto 2 zera preventivi, pasi nuk janë të regjistruara në Katalogun Kombëtar Shqiptar të Varieteteve.

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.” Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e

përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, duke sjellë konkurrencën e drejte ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Si konkluzion, kërkojmë:

1. Pranimin e Ankeses tonë si të drejtë dhe të bazuar në Ligj
2. Korrigjimin e kritereve teknike të konstatuara dhe të kontestuara nga ana jone.
3. Modifikimin e kritereve teknike të Dokumentave Standarte të Tenderit.

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

JO

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

JO

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

akajmaku@yahoo.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Merita Kajmaku